

REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK
PROJEKTI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË DHE ENERGJI TË RIPËRTËRITSHME (PKEER)
KËRKESË PËR SHPREHJE TË INTERESIT
(SHËRBIME KONSULENTE – PËRZGJEDHJA E KOMPANIVE)
PËR
MBËSHTETJE RREGULLATIVE PËR KORNIZËN RREGULLATIVE PËR ENERGJI TË RIPËRTËRITSHME DHE
INTEGRIM TË RRJETIT.

Shteti: **Kosovë.**
Nr. i projektit **P143055**
Nr. i kredisë **55080XK**
Titulli: **Mbështetje rregullative për kornizën rregullative për energji të ripërtëritshme dhe integrim të rrjetit**
Nr. i referencës **PKEER /2A1/2015**

Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka aplikuar për financimin nga Banka Botërore për Projektin për Efiçencë të Energjisë dhe Energji të Ripërtëritshme, dhe synon t'i shfrytëzojë një pjesë të të ardhurave për shërbime të konsulencës.

Shërbimet e konsulencës ("Shërbimet") kërkojnë një kompani të kualifikuar konsulente që ta rishikojë dhe përditësojë strukturën e tarifave në Zyrën e Rregullatorit për Energji për teknologji të energjisë së ripërtëritshme dhe ngrohjes qendrore. Në mbështetje të këtyre qëllimeve, do të realizohet edhe një studim i integritit të rrjetit. Për përfundimin e këtij angazhimi, pritet që të kryhen veprimet në vijim:

Detyra 1: Zhvillimi i modelit për tarifën e ngrohjes qendrore;

Detyra 2: Rishikimi gjithëpërfshirës i kornizës rregullative për energji të ripërtëritshme dhe plani për riorganizimin:

- a) Analiza e barrierave për t'i vlerësuar barrierat rregullative dhe institucionale që kanë parandaluar procedimin e mëtejshëm të aplikacioneve;
- b) Zhvillimi i energjisë së ripërtëritshme, skemës së tarifave stimuluese (feed-in) dhe modeli financiar për projekte të biogazit dhe biomasës
- c) Komponenti i integritit të rrjetit të energjisë së ripërtëritshme

Kontrata pritet të realizohet gjatë periudhës Qershor 2015 - Maj 2016. (Niveli i përpjekjeve për këtë angazhim është vlerësuar të jetë rreth 560 ditë për person, me rreth 25% që pritet të realizohen nga konsulentë vendorë).

Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE), për dhe në emër të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), tani fton kompanitë e kualifikuara konsulente ("Konsulentët") që të shprehin interesin e tyre në ofrimin e Shërbimeve. Konsulentët e interesuar duhet të paraqesin informacionin përkatës për të dëshmuar se posedojnë kualifikimet e kërkuara dhe përvojën relevante për t'i kryer shërbimet. Kriteret për listë të shkurtër janë:

- (i) Përvoja e Përgjithshme në rregullimin e sektorit të energjisë (30%),
- (ii) Përvoja përkatëse me angazhime të ngjashme (50%) dhe
- (iii) Organizimi dhe stafi (20%).

Konsulentëve të interesuar ju tërheqim vëmendjen në paragrafin 1.9 të Udhëzimeve të Bankës Botërore: *Përzgjedhja dhe angazhimi i Konsulentëve (në kuadër të Kredive të IBRD dhe Kredive dhe Granteve të IDA)*

nga Huamarrësit e Bankës Botërore datë janar 2011 ("Udhëzimet për Konsulentpët"), që përcaktojnë Politikat e Bankës Botërore mbi konfliktin e interesave.

Konsulentët mund të bashkohen me kompani të tjera në formën e një sipërmarrjeje të përbashkët ose nënkonsulente për t'i zgjeruar kualifikimet e tyre.

Konsulenti do të përzgjidhet në përputhje me Përzgjedhjen e Bazuar në Cilësi dhe Kosto (PBCK) të përcaktuar në Udhëzimet për Konsulentët.

Informata të mëtejme mund të sigurohen në adresën e mëposhtme gjatë orarit të punës: 9:00-16:00 (e Hënë deri te Premten).

Shprehjet e interesit duhet të dorëzohen në formë të shkruar në adresën e mëposhtme deri më 29 Maj 2015, në orën 16:00.

Qeveria e Republikës së Kosovës
Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE)
Projekti i Kosovës për Efiçencë të Energjisë dhe Energji të Ripërtërishme (PKEEER)
Zyra nr. 104 (kati i parë)
Rr. Nëna Terezë nr. 36
10 000 Prishtinë – Kosovë.

Për vëmendjen e:

Z. Selami Berisha

Drejtor i Prokurimit - MZHE

Tel: +38 1 38 200 21 532

E-mail: selami.berisha@rks-gov.net